



Republika e Kosovës-  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*



Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve  
Nacionalni Autoritet za Kualifikacije  
National Qualification Authority

Numër: 01-129

Datë: 27.02.2017

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 10 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare të datës 7 nëntor 2008, Udhëzimit Administrativ nr. 28/2014 "Për Kriteret dhe Procedurat për Verifikimin e Standardit të Profesionit" dhe Rregullores së Punës të KD- AKK-së, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 16.02.2017 nxjerr këtë:

## V E N D I M

1. Gjatë procesit të verifikimit të standardeve profesionale, panelistët obligohen të ndërhyjnë dhe shtojnë rekomandimet me shkrim në dokumentin e standardit të profesionit që e verifikojnë nëse nevoja e ndërhyrjes është me vogël se 30 %, në të kundërtën ai dokument kthehet tek zhvilluesi sipas legjislaturës në fuqi;

### Arsyetim

Në bazë të vlerësimit të gjendjes rreth procesit të verifikimit të standardeve të profesionit, ku në disa raste rekomandimet e panelistëve të dala nga raportet e verifikimit nuk janë marr parasysh nga zhvilluesit për ti përfshirë ato në kuadër të dokumentit të standardeve të profesionit dhe si pasojë e kësaj ato standarde janë të pa aprovuara nga KD i AKK-së , Këshilli Drejtues i AKK-së me qëllim të funksionimit të mirëfilltë të këtij procesi merr këtë vendim.

2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

3. Vendimi u dërgohet:

- Arkivit të AKK



Anëtar i KD së AKK-së  
Bedri Xhafa